

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM PËR INFRASTRUKTURË TË DEDIKUAR OPTIKE DHE SHËRBIME DATA”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbimet e internetit 72400000-4, Rrjeti internet 32412110-8.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave: 74,398,398.83 (shtatëdhjetë e katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa tvsh, 741,463 (shtatëqind e dyzet e një mijë e katërqind gjashtëdhjetë e tre) euro pa tvsh.

Shënim: Fondi limit për procedurën e prokurimit "Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data" është përlogaritur sipas numrit të ditëve të specifikuara në formularin e preventivit, bashkëlidhur dokumentave standarte të tenderit.

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 26/07/2024 është 100.34 Lekë/Euro*

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr. 125, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, i ndryshuar.

Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes :

Bazuar në Nenin 61 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur, siç është rasti i Shërbimit “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data”. Gjithashtu kjo zgjedhje e marrëveshjes kuadër me 1 Operator ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për këtë procedurë prokurimi, është se objekti i prokurimit parashikon një shërbim periodik dhe të vazhdueshëm dhe për këtë arsye realizimi i shërbimit nga operatorë ekonomik të ndryshëm nuk është i favorshëm duke i shkaktuar vështirësi autoritetit kontraktor. Bazuar dhe në rekomandimet e APP-së, është përzgjedhur lloji i Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Kryerja e shërbimit të kërkuar nga AK nga operatorë të ndryshëm ekonomikë nuk do të ishte i favorshëm, pasi do të shoqërohej me kosto shtesë dhe vonesa të shërbimit objekt prokurimi, për kryerjen e procedurave të minikonkurimit nga AK, palë e kësaj MK duke shkaktuar vështirësi në realizimin e shërbimit në rast vonese të ofrimit të shërbimit.

2.Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE ku të gjitha kushtet nuk janë të përcaktuara do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të kryerjes së shërbimit. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për realizimin e shërbimit në kohën e kërkuar nga AK.

Marrëveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshëm për pjesëmarrjen e tyre në

minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre.

Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështime në realizimin e shërbimit duke rrezikuar dhe procesin e punës.

Me qëllim garantimin e kryerjes së shërbimit në afatet kohore të përcaktuara për AK përfitues MK me një OE të vetëm do të garantonte sigurinë e kryerjes së shërbimeve kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Afati kohor i ofrimit të shërbimit “Tabela 1, Tabela 2.1, Tabela 2.2, Tabela 2.3, Tabela 4 “, është parashikuar për një periudhë kohore prej 855 (tetëqind e pesëdhjetë e pesë) ditë.

Afati kohor i ofrimit të shërbimit për pikat e “Tabela 1.1; Tabela 2.4 & Tabela 3.1_situata të pritshme) do të fillojë dhe përfundojë sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor brenda kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër.

Faturimi i shërbimit për çdo vendndodhje (Situata aktuale, Situata e Pritshme) do të realizohet për sa kohë vendndodhja do të ketë shërbim aktiv. Në rast se ndonjë nga vendndodhjet/ pikat nuk do të duhet të jetë më aktive (në ofrimin e shërbimit) me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, vendndodhja /pika respektive nuk do të vijojë të faturohet nga operatori ekonomik.

Periudha e implementimit/aktivizimit të shërbimit do të jetë deri në 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Faturimi do të fillojë në momentin që shërbimi do të jetë aktiv për secilën vendndodhje, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të artikujve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK. Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka përdorimi i ndërlidhjes së internetit si mjet furnizues për Bashkinë e Tiranës, 24 Njësitë administrative, 3 Lagjet, Institucionet e Varësisë së Bashkisë Tiranë si dhe ambientet publike që ato kanë nën administrim (parqe, sheshe, parkime nëntokësorë, terminale, sheshparkime) me shërbim Interneti/INTRANETI, Shërbim internet të dedikuar (500Mbps/500Mbps) për zyrat qendrore dhe zyrat satelite të saj. Zyrat satelite duhet të lidhen direkt (Point-to-Point Dark fiber) me zyrën qendrore me anë të fibrave optike të terminuara në zyrën Qendrore të Bashkisë Tiranë.

Shërbim internet të dedikuar 500/200 Mbps, i cili duhet të terminojë në infrastrukturën qendrore të Bashkisë Tiranë. Kjo linjë do të jetë e dedikuar për ofrimin e shërbimit WiFi (Free) në ambientet publike nën administrim të institucionit ku është vendosur infrastruktura për ofrimin e shërbimit Wifi, për përdorim nga vizitorët, turistët e këtyre ambienteve. Këto ambiente ku do të ofrohet shërbimi WiFi, duhet të lidhen direkt (Point-to-Point Dark fiber) me zyrën qendrore me anë të fibrave optike të terminuara në zyrën Qendrore.

Shërbim internet me gjerësi brezi sipas kërkesave në këtë dokument, të ofruar nëpërmjet teknologjive Fiber Optike, xDSL (aty ku është e pamundur të vendoset fiber optike), Wireless ose ekuivalente, sipas kapaciteteve të përcaktuara në këtë dokument, 50Mbps/50Mbps, 100Mbps/100Mbps, 20Mbps/20Mbps, 30Mbps/5Mbps, 5Mbps/5Mbps, 16Mbps/3Mbps.

Shërbim internet nëpërmjet Kartave Sim (SIMcard) për të mundësuar aksesimin nga terreni të aplikacioneve në përdorim të Institucionit.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësoje realizimin e kontratës, rrjedhimisht nga mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar): citojme Neni 83 i LPP (i ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP (i ndryshuar), nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës

përkatësisht:148,796,798 (njëqind e dyzet e tetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pika 2 (a) konkretisht:

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kontratës objekt prokurimi.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kriteri i vendosur është në përputhje me nenin 41, pika 3 të VKM së sipërcituar dhe garanton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, kanë realizuar kontrata të ngjashme me ente publike apo me sektorin privat dhe i kanë përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë. Vlera jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës, është vlerë e arsyeshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrit të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimit objekt kontrate. Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën/Autorizimin përkatës.

Argumenti: Referuar nenit 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

- “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, Operatori Ekonomik duhet ta vërtetojë duke dorëzuar Certifikatën/Autorizimin përkatës nga AKEP, bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar) dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrime specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

AKEP rezervon të drejtën të autorizojë një sipërmarrës/subjekt të ofrojë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, dhe i jep të drejtë të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun si dhe të marri pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta në skemën e shërbimit universal ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, AKEP monitoron të gjithë infrastrukturën e çdo operatori i cili e ka të detyrueshme paraqitjen e shtrirjes së rrjetit të tij pranë AKEP sipas teknologjisë përkatëse që operatori disponon.

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e certifikatës /autorizimit nga AKEP, për shërbimin objekt kontrate, është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e shërbimeve dhe të teknologjisë përkatëse që do të përdoret.

2.3.3 Operatori duhet të jetë i regjistruar në RIPE. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të regjistrimit pranë RIPE NCC.

Argumentimi: *Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:*

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*
- b) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*
- c) *kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Referuar nenit 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

RIPE NCC, si një regjistër rajonal interneti, ka autoritetin të delegojë burime interneti në zonën e tij të shërbimit dhe kryen aktivitete në dobi të antarëve të tij dhe palëve të interesuara.

Regjistrimi pranë RIPE NCC garanton për anëtarët një gamë të gjerë shërbimesh të anëtarësimit, siç janë mjetet e trajnimit dhe analizës së Internetit, që NCC RIPE ofron për të ndihmuar kompanitë anëtare me operacionet e tyre teknike.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4. Operatori duhet të ketë të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e Internetit. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë mbi përdorimin e Aksesit Global në Internet.

Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.*

Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) lidhjeve ndërkombëtare për shërbimin e internetit garanton Autoritetin për një performancë dhe disponueshmëri, rezervë alternative në rast të dështimeve, duke siguruar kështu një cilësi të lartë të ofrimit të shërbimit në territorin shqiptar dhe duke garantuar një kontratë të suksesshme.

Nëpërmjet kësaj kontrate do të mundësohet ofrimi i shërbimit të internetit për zyrat qendrore dhe zyrat satelite (lidhje dark fiber) të Bashkisë Tiranë, për njësitë administrative dhe Institucionet në Varësi të saj, linjë e dedikuar për ofrimin e shërbimit WiFi të BT si dhe shërbim internet nëpërmjet kartave Sim (simcard). Mungesa e shërbimit internet do të impaktojë në kryerjen e shërbimeve që Institucioni ofron nëpërmjet internetit dhe si rrjedhojë nuk do të merren në kohë masat për rikthimin e shërbimit.

Thënë kjo, për shkak të rëndësisë që kjo kontratë ka, mungesa e shërbimit është e patolerueshme për AK dhe për këtë arsye është e nevojshme dhe e domosdoshme për të ofruar alternative në rast dështimi.

Për sa më sipër, kërkesa për të paktën 2 lidhje ndërkombëtare për shërbimin e internetit garanton Autoritetin Kontraktor për vazhdueshmërinë e shërbimit në raste të ndërprerjes së lidhjeve fizike (fiber optike), apo ndërprerje shërbimi të pajisjeve brenda apo jashtë territorit të Shqipërisë, duke shmangur kështu mungesën totale të aksesit në internet.

Duke pasur parasysh kompleksitetin, rëndësinë dhe domosdoshmërinë e marrjes së shërbimit objekt i kësaj kontrate, kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe është kusht thelbësor për të garantuar performancë, disponueshmëri dhe rezervë alternative në rast të dështimeve, duke siguruar kështu një cilësi të lartë të ofrimit të shërbimit në territorin shqiptar dhe duke garantuar përmbushjen me sukses të kontratës brenda parametrave të kërkuar në DST.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

a) Standardin ISO 9001 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b)Standardin ISO 27001 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

c) Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standardin ISO 20000-1 ose ekuivalent, (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Neni 44 - Kërkesat e cilësisë, pika 1, ku citohet:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

a)Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e ofrimit të shërbimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga ofruesi i shërbimit, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca, profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, sigurimi i konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin.

Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Referuar sa më sipër, kërkesa për ISO 9001, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b)Kërkesa për ISO 27001 është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës pasi:

ISO 27001 është një kuadër standartizues përsa i përket garancisë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambjente sensitive.

Referuar sa më sipër, ky standard i kërkuar, lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi operatori ekonomik do të realizojë shërbimin e instalimit dhe konfigurimeve të nevojshme për vijueshmërinë e shërbimit të internetit e intranetit, dhe shërbimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme përgjatë afatit të kontratës, për të garantuar mbarëvajtjen e proceseve teknologjike të punës, shërbime të cilat domosdoshmërisht kërkojnë akses në infrastrukturën e autoritetit. Aksesin në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë për të

realizuar shërbimet sa më sipër do të jetë i kontrolluar e monitoruar nga stafi i Bashkisë, megjithatë certifikimi ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme që kërkohet.

c) Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Kjo certifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT do të menaxhohen sipas standardeve me të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, pasi të gjithë elementët e kontratës dhe komponentët përbërës, lidhen me shërbime të teknologjisë së informacionit.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e shërbimit.

2.3.6. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit në linjat kryesore të Institucionit, si dhe në të gjitha vendndodhjet e kërkuara, duhet të përmbushë minimalisht kushtet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës të certifikuar si më poshtë:

- a) Të paktën 2 (dy) inxhinierë të pajisur me certifikatë CCNA Certified Network Associate Routing & Switching ose ekuivalente.
- b) Të paktën 2 (dy) teknik të certifikuar SCTE (min certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës inxhinier të certifikuar për siguri kibernetike.

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata për specialistët e kërkuar;
- Diplomat universitare në degët Inxhinieri Telekomunikacioni/Elektronike/Informatike/Teknologji Informacioni
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (tipin e certifikatave dhe diplomave përkatëse) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Argumentimi: Bazuar në nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) përcaktohet:

..Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën..."

Çertifikata e kërkuar sipas pikës a) të kriterit 2.3.6, ka në thelb realizimin e instalimit të pajisjeve fundore në funksion të ofrimit të shërbimit, administrimin e pajisjeve si routera, switche si dhe implementimin e zgjidhjeve teknike (të tilla si: VLAN, protokolle trasmetimi të paketave RIP, EIGRP etj).

Është esenciale që stafi i Operatorit Ekonomik të jetë i trajnuar dhe i certifikuar sipas kushteve të kësaj certifikate ose ekuivalente me të, për të garantuar dhënien e suportit në rast problemi në pikat e ofrimit të shërbimit të internetit/intranetit të vendndodhjeve objekt kontrate, duke garantuar vijimësinë dhe shërbim cilësor dhe pa ndërprerje 24 orë/7 ditë të javës.

Qëllimi i kërkesës për këtë ekspertizë, është që autoriteti kontraktor të garantohet se operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi për të kryer detyrat e për të përmbushur kontratën në tërësi.

Çertifikata e kërkuar sipas pikës b) të kriterit 2.3.6:

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, personelin e nevojshëm, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) parashikohet se: "Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës".

Në zbatim të dispozitave ligjore të sipërpërmendura, kriteri i vendosur për të paktën 2 (dy) teknik të certifikuar SCTE (min certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente është në përputhje dhe përpjestim me objektin dhe volumin e kontratës së prokurimit, bazuar kjo në domosdoshmërinë e vijueshmërisë së shërbimeve 24/7 ditë të javës si dhe në shpërndarjen gjeografike të konsiderueshme të vendndodhjeve ku do të ofrohet ky shërbim, në territorin e Bashkisë së Tiranës.

Duke ditur se:

SCTE është një organizatë certifikuese e themeluar në vitin 1945, me qendër në Watford, Britani e Madhe dhe ofron një sërë kursesh dhe trajnimesh për profesionistë në fushën e telekomunikacionit kabllor. SCTE (certifikim në nivel teknik) ofron trajnime si teknik të instalimit, teknik të shërbimit, teknik të rrjetit etj. Gjithashtu njihet ndërkombëtarisht si një nga pesë organet certifikuese më të mira në fushën e teknologjisë së informacionit. Çertifikatat SCTE kanë një bazë të gjerë të njohurive të ndërtimit të rrjetave, njohuri të teknologjisë Wifi, si dhe bazohen në testimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave të teknologjive të ndryshme si Fibra, Koaksial etj.

Kërkesa për të paktën 2 (dy) teknik të certifikuar SCTE (min certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente është e nevojshme dhe e domosdoshme për realizimin e lidhjeve të Fibrave Optike, të konfigurimeve të nevojshme si dhe për të garantuar mirëmbajtjen e shërbimit përgjatë periudhës së kërkuar në përmbushje të SLA, objekt kontrate.

Kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës. Niveli i kërkuar teknik garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike për realizimin e shërbimeve të kërkuara. Çertifikata e kërkuar sipas pikës c) të kriterit 2.3.6:

Bazuar në nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) përcaktohet:

..Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”*

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës inxhinier të certifikuar për siguri kibernetike është një kërkesë e domosdoshme e cila i provon autoritetit se Operatori Ekonomik ka në përbërjen e tij staf të kualifikuar në implementimin e metodave për të siguruar rrjetin nga sulmet e mundshme kibernetike, konkretisht (por nuk kufizohet në) me zërat:

...“

- Rrjeti duhet të **jetë i sigurtë, i mbrojtur** dhe me parametra teknike që të sigurojnë shërbime për transmetime multimediale data, voice video.
 - Për të gjitha IP publike të kërkuara, **të realizohet mbrojtje ndaj sulmeve DDoS dhe SYN Attack.**
- ...”

Duke marrë në konsideratë rëndësinë kritike që ka ky shërbim për Autoritetin, niveli i sigurisë duhet të jetë i lartë për të parandaluar sulme të mundshme, aksese të pa autorizuara në rrjetin e Bashkisë Tiranë, dhe për më tepër ndërprerjen e shërbimeve si pasojë e sulmeve kibernetike.

Referuar sa më sipër kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka në stafin e tij inxhinier të certifikuar për siguri kibernetike për të përmbushur shërbimet e kërkuara objekt kontrate.

Shënim: Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, referuar nenit 82 të LPP-së (i ndryshuar) dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar). Në vijim Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftim fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentacionin provues sipas përcaktimit të bërë në këtë kriter.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për

kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”, I ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Bashkia e Tiranës nëpërmjet kësaj kontrate kërkon të mundësojë:

- Shërbim internet të dedikuar (500Mbps/500Mbps) për zyrat qendrore dhe zyrat satelite të saj.
- Shërbim internet të dedikuar 500/200 Mbps, i cili duhet të terminojë në infrastrukturën qendrore të Bashkisë Tiranë. Kjo linjë do të jetë e dedikuar për ofrimin e shërbimit WiFi (Free) në ambientet publike nën administrim të institucionit, për përdorim nga vizitorët, turistët e këtyre ambienteve.
- Shërbim internet me gjerësi brezi (bandwidth) të limituar, të ofruar nëpërmjet teknologjive Fiber Optike, xDSL, Wireless ose ekuivalente, sipas kapaciteteve të përcaktuara në dokumentin e Termave të referencës

dhe specifikimeve teknike (50Mbps/50Mbps, 100Mbps/100Mbps, 20Mbps/20Mbps, 30Mbps/5Mbps, 30Mbps/5Mbps, 16Mbps/3Mbps).

➤ Shërbim internet nëpërmjet Kartave Sim (simcard) për të mundësuar aksesimin nga terreni të aplikacioneve në përdorim të Institucionit.

Specifikimet mbi shërbimet e kërkuara si më sipër (por jo vetëm) janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe mundëson që OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit

Termtat e Referencës/ Specifikimet teknike

NJËSIA E PROKURIMIT